



## ODA EKONOMIKE E KOSOVËS

19.10.2023

PRISHTINË

Me Ligjin Nr. 2004/7, nenit 19, paragrafil (d) dhe Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave personale, Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës sjellë këtë:

### VENDIM

1. Zyrtarja, znj. **Nexhmije Krasniqi**, caktohet Zyrtare përgjegjëse në Odën Ekonomike të Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave personale.
2. Zyrtarja nga pika 1. e këtij vendimi për Mbrojtjen e të Dhënave personale, kryen detyra të përcaktuara me Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në veqanti por jo vetëm ato të parapara me nenin 39 të ligjit nr. 06/L-082.
3. Zyrtarja përgjegjëse bashkëpunon dhe vepron si pikë kontakti me Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
4. Raporton drejtpërsëdrejti nivelit më të lartë të Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës.
5. Në përmbushje të detyrave të saj i nënshtrohet fshehtësisë ose konfidencialitetit.
6. Kryen edhe detyra të tjera, nëse të njejtat nuk rezultojnë me konflikt interesi.

### ARSYETIM

Oda Ekonomike e Kosovës në referim të rregullatives juridike në fuqi respektivisht Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave personale, e me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të parapara me nenin 37 të ligjit, përmes këtij akti formal, cakton Zyrtaren përgjegjëse, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Me rastin e caktimit të Zyrtares së cekur në piken një të dispozitivit të këtij vendimi për të qenë Zyrtare përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale, kryetari i Odës Ekonomike mori për bazë profilin, performancën, përgatitjen profesionale si dhe kredibilitetin e saj, e në veqanti njohuritë lidhur me organizimin, strukturën dhe veprimtaritë tjera në kuader të Odës, duke

vlërësuar njëkohësisht se zyrtarja në fjalë plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e kësaj detyre.

Kryetari i Odës Ekonomike mbi bazën e të cekurave si më lartë dhe me qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore, si dhe kërkesës nr. Prot 36 të datës 19.10.2023, të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës

Lulzim Rafuna



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit
- Zyrtarit Përgjegjës
- Arkivit